

NJOFTIM PËR MEDIAN

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), në datën 30.07.2019, zhvilloi mbledhjen e radhës me këtë rend dite:

1 . Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të një pjese të kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Shqyrtimi i rasteve të kandidatëve për vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë është vendosur në përfundim të procedurave të verifikimit rigoroz dhe të thelluar të ndjekura nga Këshilli, sipas ligjit dhe standardeve tashmë të njohura e të aplikuara që kërkohen për përzgjedhjen, qenien dhe konfirmimin në detyrën e magjistratit apo anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Në mënyrë të përmbledhur, në veprimet hetimore dhe procedurat e verifikimit të kandidatëve të ndjekura nga Këshilli, ndër të tjera, përfshihen:

- në lidhje me kontrollin e pasurisë, hetimi i ushtruar dhe raporti i kontrollit nga ILDKPKI, të dhënat e sjella nga me shumë se 45 institucione publike dhe subjektet private të fushës bankare, financiare, tregtare, tatimore, sigurimeve shoqerore etj., në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit, si edhe shpjegimet e dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidatët rast pas rasti në përgjigje të kërkesave të Këshillit;

- në lidhje me figurën dhe integritetin, hetimi i ushtruar dhe raportet apo përgjigjet zyrtare të dërguara nga institucionet publike si Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, të gjitha institucionet e shërbimeve informative, si edhe shpjegimet e dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidatët rast pas rasti në përgjigje të kërkesave të Këshillit;

- në lidhje me kushtet e tjera ligjore të kandidimit, verifikimi dhe hetimi mbi dokumentacionin e kandidimit të paraqitur nga vetë kandidatët, të dhënat zyrtare të sjella nga institucione publike dhe subjekte private mbi kërkesat për informacion të Këshillit lidhur me karrierën, performacën e kandidatëve dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e kandidatëve në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve, si edhe shpjegimet e dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidatët rast pas rasti në përgjigje të kërkesave të Këshillit.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vlerëson se është rasti për të përshëndetur dhe falenderuar për përgjegjshmërinë, korrektësinë dhe shpejtësinë, në dhënien e përgjigjeve dhe sjelljen e informacioneve të plota dhe profesionale të kërkuara nga shumica dërmuese e institucioneve publike dhe subjekteve private.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi shqyrtoi aktet dhe procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave dhe dokumentacionin e përgatitur lidhur me plotësimin e kushteve ligjore për kandidim, për secilin kandidat të përcaktuar në rendin e ditës, pasi dëgjoi

mendimin e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit lidhur me procedurën e ndjekur në verifikimin e kandidaturave, vendosi:

A. Lejimin e kandidimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese si më poshtë:

1. **Elsa Toska**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
2. **Elsa Toska**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;
3. **Elsa Toska**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019;
4. **Elsa Toska**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019;

B. Ndalimin e kandidimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese si më poshtë:

1. **Valbona Bala**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
2. **Valbona Bala**, për vendin vakant (vakancë e parakohshme) të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.
3. **Valbona Bala**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;
4. **Valbona Bala**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019;
5. **Valbona Bala**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019;
6. **Valbona Bala**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 28.08.2018;

7. **Klodian Rado**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019;
8. **Klodian Rado**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019;

9. **Rexhep Bekteshi**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
10. **Rexhep Bekteshi**, për vendin vakant (vakancë e parakohshme) të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
11. **Rexhep Bekteshi**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;

12. **Sinan Tafaj**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
13. **Sinan Tafaj**, për vendin vakant (vakancë e parakohshme) të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.
14. **Sinan Tafaj**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;
15. **Sinan Tafaj**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 28.08.2018;

16. **Petrit Kaja**, për vendin vakant, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;

17. **Petrit Kaja**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.

18. **Gëzim Allaraj**, për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;

19. **Gëzim Allaraj**, për vendin vakant, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;

20. **Gëzim Allaraj**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018.

21. **Fiona Papajorgji**, për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 28.08.2018;

C. Lejimin e kandidimit të kandidatit **Artur Metani**, për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ç. Ndalimin e kandidimit të kandidatit **Genci Gjonçaj** për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

D. Vendimet lidhur me lejimin ose ndalimin e kandidimit të kandidatëve **Eris Hysi** dhe **Klodian Rado** për vendin vakant, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, shtyhen për mbledhjen e radhës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

E. Gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të kandidatëve **Zhaklina Peto** dhe **Marsida Xhaferllari**, për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Vendimet për lejimin ose ndalimin e kandidimit, do të publikohen të arsyetuara në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Zyra e Shtypit

Tel/Fax:04227806

<http://www.gjykataelarte.gov.al>